



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 24 Qershor 2021

Nr. 419

VENDIM

- Objekt:** Për shqyrtimin administrativ të kallëzimit, për shkelje të parashikuara në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, Lushnjë
- Kërkues:** Lëvizja Socialiste për Integrim
- Ndaj:** Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Lushnjë
- Baza Ligjore:** Neni 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 60, 61 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

VËREN:

I. Vlerësimi paraprak

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në datën 24.04.2021 në portalin e denoncimeve, është raportuar denoncimi me nr. ID të gjeneruar nga sistemi 3314, nga subjekti politik, Partia “Lëvizja Socialiste për Integrim”, për një veprimtari të datës 24.04.2021, të Drejtorisë së Bujqësisë Vlorë dhe Fier.

Sipas denoncuesit në portalin zyrtar të lajmeve “Fax Web” është konstatuar se, pikërisht një ditë para zgjedhjeve, Drejtoria e Bujqësisë në Vlorë dhe Fier, shpërndan tollone nafte për fermerët të cilët kishin muaj



në pritje, në kundërshtim të plotë me nenin 3, pika 1.3, gërma “c” dhe “ç” të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Në cilësinë e provës, denoncuesi ka paraqitur edhe linkun si më poshtë vijon:

<https://www.faxweb.al/deri-ne-oren-e-fundit-drejtoria-e-bujqesise-ne-vlore-dhe-fier-shperndan-tollone-nafte-per-fermeret-kishin-me-muaj-ne-pritje-kujtohen-nje-dite-para-zgjedhjeve/>

Referuar nenit 23 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se “*Me fillimin e procedurës administrative, organi publik verifikon nëse ka apo jo kompetencë lëndore dhe tokësore për të vendosur për çështjen objekt shqyrtimi*”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht faktin nëse është apo jo organi publik kompetent, për shqyrtimin e tyre.

Juridiksioni dhe kompetenca janë parakushte procedurale që duhet të plotësohen në mënyrë që të krijohet një marrëdhënie juridike procedurale e vlefshme.

Sipas përcaktimeve të neneve 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Lidhur me këtë kallëzim të Lëvizjes Socialiste për Integrim, i cili ka si objekt “Shkelje të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve” Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se ky ankim është objekt shqyrtimi nga ana e tij.

Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se të dhënat e paraqitura nga subjekti kallëzues z. Zeqaj, përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.



II. Rrethanat e faktit

Komisioni Rregullator në KQZ, me datë 24.12.2020 ka miratuar vendimin nr. 9 “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”. Ky akt normativ ka hyrë në fuqi menjëherë pas miratimit të tij dhe është publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së në datën 26.12.2020.

Referuar denoncimit të mësipërm, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 4988 prot., datë 06.05.2021, i ka kërkuar Drejtorisë së Bujqësisë Vlorë dhe Fier, informacion sqarues lidhur me këtë veprimtari.

Gjithashtu, me shkresën nr. 5184 prot., datë 12.05.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion sqarues, për një shqyrtim sa më të shpejtë të çështjes edhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, lidhur me këtë veprimtari të institucioneve të saj të varësisë.

Me shkresën nr. 398/1 prot., datë 2021, protokolluar me tonën me nr. 4988/1 prot., datë 15.5.2021, Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Lushnje, ka kthyer përgjigje në të cilën na informon se:

- Ish-drejtoritë e bujqësisë janë organizuar në emërtesën Agjencia Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Lushnjë, e cila mbulon qarqet Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë.
- AREB Lushnje ka kryer procedurat e ngarkuara që lidhen me sqarimin e fermerëve, asistencën në aplikime, verifikimet e aplikimeve, miratimin e aplikimeve, shpërndarjen e kartave të naftës për fermerët dhe një sërë detyrash të tjera, si një detyrim i vendosur dhe jo me iniciativën e tyre por si një aktivitet i shtrirë në kohë sipas afateve dhe procedurave të parashikuara ligjore dhe nënligjore. Gjatë gjithë veprimtarisë, nuk ka pasur asnjë ankesë nga asnjë fermer që në një rast të caktuar të jetë kërkuar vota për subjekte politike, por është kryer vetëm detyra administrative që ngarkohej nga aktet përkatëse ligjore.
- Sa i përket daljes në punë jashtë orarit zyrtar, sikurse udhëzimi nr. 1, datë 8.1.2021 “Për kriteret, procedurat dhe menyrën e administrimit të skemës së mbështjetjes me naftë për bujqësinë” i ndryshuar, parashikon:
“Në kreun III: “3.Periudha e aplikimit është nga data 15 janar 2021 deri më datë 30 mars 2021”.
“Në kreun 4:”13. Pas dërgimit të suksesshëm të aplikimit, përgjigja mbi rezultatit e aplikimit (i



kalifikuar/i skualifikuar), dërgohet tek aplikuesit, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të periudhës së aplikimeve.

- Pra fakti se kjo periudhë është periudha e punimit dhe mbjelljes së tokës për shumicën e kulturave bujqësore, shpërndarja e naftës (nëpërmjet dhënies së kartave përkatëse”, ka qenë një proces i detyrueshëm për tu kryer nga punonjësit e kësaj agjencie. Është natyra e aktiviteteve bujqësore që lidhet me sezonin bujqësor dhe me bujqësinë dhe jo synime të natyrave të tjera që kanë detyruar kryerjen e veprimtarisë administrative edhe jashtë orarit zyrtar.
- Në përgjigjen e dhënë theksohet gjithashtu se, AREB Lushnjë mbulon 3 qarqet me volumin më të madh të bujqësisë, Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë dhe ka proceduar 7017 aplikime me një staf shumë të limituar. Kështu, rrjedhimisht me qëllim përmbushjen e detyrimeve, është punuar me orare të zgjatura. Aktiviteti është kryer dhe në javën e fundit para zgjedhjeve por në ambientet e zyrave të AREB dhe jo në ambiente publike dhe pa prezencën e ndonjë kandidati apo subjekti zgjedhor.

Me shkresën nr. 3500/1 prot., datë 20.05.2021, protokolluar me tonën me nr. 5184/1 prot., datë 21.5.2021, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, z. Enea Hoti, ka kthyer përgjigje në të cilën sqaron se:

Veprimtaria e kryer nga Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Lushnjë, është një veprimtari administrative që vjen si rezultat i përmbushjes së parashikimeve përcaktuar në VKM-në nr. 1142, datë 24.12.2020, *“Për përcaktimin e kriterëve bazë, masës së përfitimit dhe mënyrës së përdorimit të fondit, për skemën e mbështetjes me naftë për bujqësinë, për vitin 2021”* dhe udhëzimit nr. 1, datë 8.1.2021 *“Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të skemës së mbështetjes me naftë për bujqësinë”*, ndryshuar me udhëzimin nr. 6, datë 4.2.2021 dhe udhëzimin nr. 8, 24.2.2021, të botuara rregullisht në Fletoren Zyrtare.

Në rang vendi ka pasur rreth 20.000 aplikime nga fermerët dhe rrjedhimisht tërësia e veprimeve administrative të kryera ka qenë shumë e madhe në përmbushje të detyrimit që shqyrtimi i aplikimeve të përfundojë brenda 30 ditëve nga përfundimi i periudhës së aplikimeve. Në këtë kuptim ka qenë e nevojshme organizimi i punës me orare të zgjatura nga të gjithë agjencitë rajonale, përfshirë këtu dhe Agjencinë Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Lushnjë.



III. Analiza ligjore

Rreferuar nenit 3, pika “c” dhe “ç” të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, parashikohet se:

- “veprimtari të ndaluara” janë edhe ato veprimtari që përfshijnë:

c- Vënie në dispozicion të asetëve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1997 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, për qëllime zgjedhore, që janë në pronësi apo administrim të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose të njësisve të vetqeverisjes vendore, apo çdolloj enti tjetër; ku shteti zotëron kapital/kuota/aksione ose/dhe emëron shumicën e organit mbikqyrës apo organit administrues të entit.

ç- Përdorimin e detyruar në fushatë zgjedhore të administratës shtetërore qendrore dhe vendore brenda orarit të punës për veprimtari dhe/ose aktivitete **për qëllime zgjedhore** edhe me mjetet e komunikimit elektronik, si dhe përdorimin në mënyrë të detyruar dhe të organizuar brenda orarit mësimor të nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar për veprimtari dhe aktivitete në funksion të zgjedhjeve, ose premtimin apo ofrimin e përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari për qëllime zgjedhore, jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimin e presionit ndaj tyre për këtë qëllim.

Sa i takon faktit nëse kjo veprimtari e Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Lushnjë është apo jo në shkelje të nenit 1.3 shkronja “c”, të vendimit 9/2020 të Komisionit Rregullator, sipas provave të administruara, rezulton e paprovuar se dhënia e tollonave të naftës fermerëve nga ana e Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Lushnjë përfshin vënie në dispozicion të asetëve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142, të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Referuar fakteve dhe provave të administruara gjatë hetimit administrativ, rezulton se kjo veprimtari është një veprimtari administrative ligjore, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, referuar më sipër, gjatë këtij vendimi.

Në shqyrtim të fakteve dhe provave të administruara gjatë hetimit administrativ, gjithashtu nuk rezulton e provuar qëllimi zgjedhor i veprimtarisë së Agjencisë Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Lushnjë, në kuptim të nenit 3, pika “ç” të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, në KQZ.



Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të vazhdojë shqyrtimin administrativ për kallëzimin e kryer nga subjekti politik “Lëvizja Socialiste për Integrim” pasi në përfundim të hetimit administrativ rezultoi se, veprimtaria Agjencisë Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Lushnjë, nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në vendimin nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60, 61 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

V E N D O S:

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të kallëzimit ndaj Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Lushnjë, pasi nuk konstatohen shkelje të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Illirjan CELIBASHI

